



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik

**01 Nr. 16- 30535 /15**  
**Kaçanik, 29.09.2015**

Në mbështetje të nenit 12.1 dhe 12.2(c) lidhur më nenin 40.2(a) dhe (g) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 11 të Ligjit Nr. 3/L-204 - Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në Kosovë të datës 25.11.2010, të Ligjit Nr. 04/L-100 – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 03/L-204, të nenit 2 dhe 9 të Ligjit nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal si dhe nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë : 29.09.2015, aprovoj këtë:

**RR E G U L L O R E**  
**PËR VENDOSJEN E TATIMIT NË PRONË NË TERRITORIN**  
**E KOMUNËS SË KAÇANIKUT, PËR VITIN 2016**

**Neni 1**

Duke u bazuar në nenin 7. të Ligjit nr. 04/L-100 - Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në Kosovë Nr. 03/L-204, në komunën e Kaçanikut për vitin 2016, shkallët (tarifat) e Tatimit në Pronën e paluajtshme në bazë vjetore do të jenë prej 0,15% deri 0,20%, më sa vijon:

<b>P ë r s h k r i m i</b>	<b>Norma</b>
1. Pronat Rezidenciale – shtëpi	0,15%
2. Pronat Rezidenciale – banesë / apartman	0,15%
3. Garazhet	0,15%
4. Pronat Komerciale	0,20%
5. Pronat Industriale	0,20%
6. Pishinat	0,20%
7. Fushat sportive ( të mbuluara )	0,20%
8. Pronat Bujqësore	0,15%
9. Pronat e papërfunduara	0,15%

## Neni 2

Duke u bazuar në vendndodhjen e pronës e cila ndikon dukshëm në vlerën e saj si dhe vlerësimeve nga Grupi punues, në Komunën e Kaçanikut janë të përcaktuar katër (4) zona, të cilat paraqesin ndryshime të theksuara në vlerën e pasurisë.

## Neni 3

**3.1.** Katër (4) zonat në territorin e komunës, të përcaktuara sipas kësaj rregullore, janë ndarë si më poshtë:

- Qyteti i Kaçanikut duke përfshirë edhe fshatin Bob, është i ndarë në tri (03) zona të vlerësimit, përkatësisht në Zonën e I, II dhe III-të;
- Zona e III-të përfshinë këto fshatra: Bajnicë, Begracë, Biçec, Doganaj, Duraj, Elezaj, Gabricë, Gajre, Gërlicë e Epërme, Kaçaniku i Vjetër, Koxhaj, Dubravë, Malësi, Nikë, Gllloboçicë, Runjevë, Soponicë, Stagovë, Kovaçec; dhe
- Në zonën e IV-të përfshihen këto fshatra: Sllatinë, Drenogllavë, Shtrazë, Ivajë, Kërbliq, Gjurgjedell, Kotlinë, Nikoc dhe Semajë;

**3.2.** Të gjitha objektet në parcelat të cilat gjinden pranë rrugës magjistrale Prishtinë – Shkup në tërë territorin e komunës dhe të cilat kanë çasje të drejtpërdrejt, si dhe ato në pjesën e rrugës regjionale Fusha e Pajtimit – Tetovë, deri te udhëkryqi për Prizren, përfshihen në zonën e I-rë.

## Neni 4

Në bazë të shqyrtimit të kontratave të shitblerjes dhe studimeve të hollësishëm të parametrave tjerë relevant, është nxjerr vlera e tregut për të gjitha llojet e objekteve duke i klasifikuar në katër (04) zona të vlerësimit, e të cilat nuk ndryshojnë nga viti paraprak.

### Normat aplikuese sipas zonave dhe vlerës së tregut në €/m<sup>2</sup> :

Zona	0,15%			0.20%		0,20%	0,20%	0,15%	0,15%
	Shtëpi banimi	Apartment - Banesë	Garazhet	Pronat komerciale	Pronat Industriale	Pishinat	Fushat Sportive	Pronat Bujqësore	Pronat e papërfunduara
I	2	3	4	5	6	7	8	9	10
<b>I</b>	300	300	150	700	200	140	125	100	120
<b>II</b>	250	300	120	500	200	125	110	80	100
<b>III</b>	200	-	100	360	150	110	95	60	80
<b>IV</b>	150	-	80	300	150	95	85	60	60

## Neni 5

Pronat të cilat lirohen nga Tatimi në Pronë, e të cilat janë të cekura në nenin 8. të të Ligjit nr. 3/L-204 - Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në Kosovë, lirohen nga tatimi edhe në Komunën e Kaçanikut.

### **Neni 6**

Shtyrja e pagesës së Tatimit në Pronë në kushte të veçanta, mund të bëhet konform të nenit 16. pika 1. të Ligjit nr. 3/L-204 - Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në Kosovë

### **Neni 7**

Në pajtim me nenin 11 pika 1.4. të Ligjit nr. 3/L-204 - Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në Kosovë - “ Përgjegjësitë Komunale ”, Kryetari i Komunës për vitin 2016 emëron Bordin e pavarur komunal për shqyrtimin e ankesave administrative të tatimpaguesve, në përbërje prej tre (3) anëtarëve.

### **Neni 8**

Ligji nr. 3/L-204 - Për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-100 – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 03/L-204 dhe Udhëzimet Administrative, rregullojnë të gjitha çështjet tjera që kanë të bëjnë me Tatimin në Pronë, e të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore komunale.

### **Neni 9**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës-MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës, ndërkaj do të zbatohet për vitin 2016.

